



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde

Analizë e politikave:
Nr. 03/2018 - IKD

Ndërhyrjet politike në sistemin e politizuar prokurorial, alarm për nevojën e vetingut në polici, prokurori dhe gjykata

**(Analizë e politikave pas ndërhyrjeve politike dhe kërcënimeve
publike ndaj prokurorit special Elez Blakaj)**

Prishtinë, gusht 2018

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD)

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Ky raport nuk paraqet domosdoshmërisht qëndrimet e donatorit.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Rrustem Statovci

Prishtinë

E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

Përkrahur nga:



British Embassy
Pristina



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world

Gusht 2018

Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja

I. Përmbledhje ekzekutive.....	4
II. Hetimet e veteranëve mashtrues	6
III. Dorëheqja e prokurorit Blakaj dëshmi e ndërhyrjeve politike në drejtësi	8
IV. Profili i prokurorit Elez Blakaj: Hero VS Frikacak	11
a) Elez Blakaj - prokuror hero.....	11
b) Elez Blakaj - prokuror frikacak.....	12
V. Shqetësimet për kërcënimet dhe etiketimet publike të politikanëve kundër prokurorit Blakaj 14	
VI. Rasti Blakaj, dëshmi për iniciativën e drejtë të IKD-së për nevojën për veting në polici, prokurori dhe gjykata.....	15
a) Siguria juridike dhe fizike e prokurorëve dhe gjykatësve	15
b) Qytetarët nuk kanë besim në sistemin e drejtësisë.....	16
c) Protesta qytetare për shkarkimin e Kryeprokurorit Lumezi dhe për vetingun në gjyqësor	17
d) Vetingu si zgjidhje e paalternativë.....	18

I. Përmbledhje ekzekutive

Kritikat e vazhdueshme për ndikimet politike dhe të grupeve të interesit në punën e prokurorëve dhe sistemit prokurorial janë dëshmuar së fundi në publikun e gjerë nga vetë protagonistin i zbatimit të ligjit – prokurori special - Elez Blakaj. Ky i fundit në rolin e zbatuesit të ligjit – si prokuror - dhe sinjalizuesit brenda sistemit prokurorial derisa ishte duke e trajtuar njërin prej rasteve më të mëdha dhe të ndjeshme pas përfundimit të luftës në Kosovë – rastin e veteranëve mashtrues - është përballur me sfida të shumta përfshi kërcënimet e vazhdueshme dhe presionet e formave të ndryshme për t’ia pamundësuar kryerjen e detyrës në këtë rast.

IKD vazhdimisht ka ngritur shqetësime në publik rreth atmosferës së krijuar në sistemin e drejtësisë, përkatësisht edhe sistemin prokurorial, e cila pamundëson ushtrimin e drejtë të funksionit të prokurorit në mënyrë të pavarur, të paanashme dhe profesionale.

Hetimet dhe ngritja e aktakuzës për rastin e veteranëve mashtrues nga prokurori special Elez Blakaj dhe dorëheqja e tij nga pozita e prokurorit dëshmojnë gjetjet e vazhdueshme të IKD-së për mungesën e sigurisë juridike por edhe fizike të prokurorëve me integritet në ushtrimin e funksionit të tyre.

Rasti i prokurorit Blakaj reprezenton gjendjen e sigurisë në sistemin prokurorial, në të cilin ndikojnë politika dhe grupet e interesit për të pamundësuar hetime dhe ndjekje penale në mënyrë të pavarur. Blakaj kishte muaj të tërë që kishte zhvilluar hetime penale në rastin e veteranëve mashtrues, në të cilin kishte përfshirë në hetime një numër të madh të personave të profilit të lartë, të cilët në kohën e luftës në Kosovë kishin shërbyer si Komandanta, ndërsa në qeverisjen aktuale mbajnë pozita të larta si Ministra, Deputet, Shefa të Policisë etj.

Ky profil i personave të hetuar nga prokurori Blakaj ka ndikuar që gjatë gjithë procesit të hetimeve të përballët me lloj lloj kërcënime dhe kërkesa të shëfave për të pasur kujdes se çfarë përfundimesh do të nxjerrë dhe se kend do ta akuzon.

Gjithë këto kërcënime dhe kërkesa u bënë të ditura për publikun për dorëheqjes nga vetë prokurori Blakaj dhe nga reagimet publike të Kryeprokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi, Këshilli Prokurorial i Kosovës, Shoqata e Prokurorëve, Kryeministri i Qeverisë Ramush Haradinaj, Kryeparlamentari Kadri Veseli, Presidenti Hashim Thaçi dhe deputetë e qeveritarë të tjerë, të cilët dëshmuar kërcënimet që kishte pasur rrugës në kryerjen e hetimeve dhe poashtu e kërcënuar sërish publikisht në forma të ndryshme. Kërcënimet ishin drejtuar ndaj prokurorit Blakaj dhe të gjithë sistemit prokurorial, duke i dërguar mesazh të qartë se kushdo që do të merret me trajtimin e rastit të veteranëve mashtrues “është i vogël për tu marr me ta” dhe se do të konsiderohet si “hajni i pulave dhe pishpirik”.

Në anën tjetër të gjitha reagimet publike të të gjithë akterëve dëshmuar punën profesionale, të paanshme dhe të pavarur të kryer nga prokurori Elez Blakaj dhe në të njëjtën kohë poashtu u dëshmuar nga vetë protafonistët e luftës së UÇK-së se i gjithë procesi për njohjen e statusit të veteranëve ishte zhvilluar në mënyrë të kundërligjshme dhe se listat ishin fryer me veteranë mashtrues. Ish-Komandantët e UÇK-së dolën publikisht dhe mbështetën aktakuzën e prokurorit Blakaj, duke konfirmuar se listat ishin fryer me veteranët mashtrues.

Në këtë situatë të krijuar, në të cilën ndikimi politik dhe ndikimi i grupeve të interesit janë evidente në procesin e punës së prokurorit Elez Blakaj dhe sistemit prokurorial, ekziston një rrezikshmëri e lartë për sigurinë juridike dhe fizike të prokurorit Blakaj dhe cilitdo prokuror, i cili tenton ta trajtojë këtë rast me integritet, pa lejuar ndikime politike.

IKD si rezultat i monitorimit sistematik në sistemin e drejtësisë ka trajtuar specifikisht temën e mungesës së sigurisë juridike dhe fizike për prokurorët dhe gjykatësit, të cilët në raste të izoluar përballen drejtpërdrejtë me kërcënime fizike, por që dukuri është përballja me presione, shantazhe dhe kërcënime të ndryshme në kryerjen e detyrave në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe profesionale, sikurse në rastin Blakaj.

Për më tepër, ndikimi politik në sistemin e drejtësisë, përkatësisht sistemin gjyqësor dhe prokurorial, theksohet vazhdimisht në të gjitha raportet më relevante vendore dhe ndërkombëtare me theks të veçantë Raporti i Progresit të Komisionit Evropian, Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit, Freedomhouse etj. Në këtë drejtim, një ndër indikatorët më të rëndësishëm që dëshmon këtë ndikim politik në sistemin e drejtësisë është besueshmëria e qytetarëve në punën e sistemin gjyqësor dhe prokurorial, e cila është ndër më të ulëtat pas përfundimit të luftës në Kosovë.

IKD insiston në iniciativën e saj publike të rekomanduar tash e sa kohë, që është formuluar si politikë duke u bazuar në gjetjet e vazhdueshme të monitorimit sistematik, që sistemi i drejtësisë të përfshihet në një veting të thellë, duke filluar prej Policisë, Prokurorisë dhe Gjyqësorit. Këtij procesi duhet t'i paraprijnë ndryshimet kushtetuese dhe më pas Ligji i Vetëingut, për të cilat nevojitet vullnet politik në Kuvendin e Kosovës. Sidoqoftë, tash për tash është e domosdoshme që sistemi prokurorial të këndellet në hapat e tij, duke shkarkuar fillimisht Kryeprokurorin e politizuar Aleksandër Lumezi, për të kaluar më pas në një tranzicion, i cili do të përgatiste procesin e vetëingut.

II. Hetimet e veteranëve mashtrues

Prokurori Special i Republikës së Kosovës, Elez Blakaj, më 11 korrik 2018, pas një pune hetimore disa mujore ka ngritur një rën ndër aktakuzat më të rëndësishme që nga përfundimi i luftës në Kosovë në vitin 1999. Aktakuza e prokurorit Blakaj, është e drejtuar kundër anëtarëve të Komisionit qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të veteranit UÇK-së, ku pjesa më e madhe tyre janë përfshirë në aktakuzë. Kjo lëndë, e cila po konsiderohet si lëndë më voluminoze dhe e ndjeshme, ende po qëndron në sirtarë të Prokurorisë Speciale dhe nuk po dërgohet në Gjykatë, edhe pse është firmosur nga prokurori Elez Blakaj.

Listës së personave të akuzuar i prinë Agim Çeku, i pasuar nga Nuredin Lushtaku, Sadik Halitjaha, Shkumbin Demaliaj, Qelë Gashi, Shukri Buja, Ahmet Daku, Rrustem Berisha, Faik Fazliu, Smajl Elezaj dhe Xhavit Jashari.

Kjo aktakuzë për shkak të ndjeshmërisë dhe profilit të lartë të përfshirë, ishte dërguar fillimisht tek Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale, Reshat Millaku, për ta dërguar më pas në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Në këtë të fundit, kjo aktakuzë nuk është dërguar ende nga Prokuroria Speciale. Ndërkohë pas dorëheqjes së prokurorit Blakaj, kjo lëndë i është ndarë prokurorit special Afrim Shefkriu.

Bazuar në aktakuzën e prokurorit Blakaj, rezulton se strategjia e tij në hetimin dhe ndjekjen e këtij rasti është bazuar në sigurimin e provave dhe dëshmimeve, të cilat e dëshmojnë procesin e njohjes së veteranëve si të kundërligjshëm në të cilin shumë individ kanë konsumuar vepra penale. Tutje, përveç aktakuzës së ngritur ndaj profilit të lartë, si kompetencë e Prokurorisë Speciale, pas saj, prokurori Blakaj ka deponuar njoftimin për shtatë Prokuroritë Themelore së bashku me prova dhe dëshmi për të vazhduar hetimin dhe ndjekjen e të gjithë personave të tjerë ku përfshihen prej të gjitha niveleve të Komandantëve të UÇK-së që kanë përpiluar dhe aprovuar listat e fryera deri tek veteranët e rrejshëm, të cilët kanë paguar në forma të ndryshme për të përfituar këtë status. Kjo nënkupton se shtatë Prokuroritë Themelore do të duhej të ngrinin aktakuza ndaj personave përgjegjës që kanë lejuar fryerjen e listave, në të cilat janë përfshirë mbi 19,000 veteranë mashtrues.

Një segment tjetër shumë i rëndësishëm i hetimit të këtij rasti të veteranëve të punuar nga prokurori Elez Blakaj është hetimi penal i iniciuar ndaj policëve dhe eprorëve në polici, të cilët në të njëjtën kohë përfitojnë të ardhura edhe si invalid të UÇK-së.

Sfidat në hetimin e këtij rasti nga prokurori Blakaj kanë qenë të mëdha për shkak të presioneve dhe kërcënimeve nga vetë veteranët, ndikimet e Kryeprokurorit Lumezi dhe Kryeministrit Haradinaj.

Gjatë hetimeve, prokurori Blakaj kishte ftuar për ta intervistuar Kryeparlamentarin Kadri Veseli, për të cilin kishte reaguar Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, duke thënë se nuk ka nevojë të ftohet për shkak se gëzon imunitet. Këtë qëndrim Lumezi e ka mbajtur edhe në publik në arsyetimet e tij, përkundër faktit se prej shtatorit 2011, sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, rezulton se askush nuk gëzon imunitet as nga ndjekja penale e lëre më që të ftohet në rolin e

dëshmitarit. Kryeparlamentari Veseli ishte ftuar për tu intervistuar nga prokurori Blakaj për shkak se në foltoren e Kuvendit, kishte deklaruar se listat ishin fryer me veteranë mashtrues.

Megjithatë, Blakaj nuk është ndalur dhe ka arritur të përpilon aktakuzën 64 faqe, me dhjetëra mijëra faqe prova dhe dëshmi për rreth 20,000 veteran mashtrues. Aktakuza e formalizuar nga Blakaj është nënshkruar, gjë që formalisht konsiderohet si punë e kryer e prokurorit, ndërsa për tu konsideruar aktakuza e ngritur, duhet të dorëzohet në Gjykatën kompetente. Në këtë të fundit, ende administrata e Prokurorisë Speciale nuk e ka dërguar, për shkak se aktakuza është ndalur nga Kryeprokurori i kësaj Prokurorie, Reshat Millaku, me arsyetimin se duhet të plotësohet teknikisht me disa informacione në dispozitivin e aktakuzës në mënyrë që mos të ketë probleme formale për pranim nga Gjykata. Për këtë proces dhe përfaqësim të lëndës të veteranëve tashmë është caktuar prokurori special Afrim Shefkriu. Sipas përgjegjësit për komunikim me publikun në Prokurorinë Speciale, prokurori Sylë Hoxha, kjo aktakuzë pritet të plotësohet dhe dërgohet në Gjykatë për një muaj.

Pas dorëheqjes së prokurorit Blakaj, Kryeministri Ramush Haradinaj përmes një postimi në facebook ka publikuar komunikimin zyrtar lidhur me hetimin e rastit të veteranëve të luftës në mes të Prokurorit Blakaj dhe Kryeministrit Haradinaj. Edhe përkundër faktit se rasti i veteranëve është ende duke i trajtuar nga sistemi prokurorial, kjo nuk e kishte penguar Kryeministrin Haradinaj që të publikoi në faqën e tij zyrtare në facebook shkresën e prokurorit Blakaj për të pasur qasje në dokumentacionin e Komisionit qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të veteranit UÇK-së si dhe përgjigjen e Kryeministrit Haradinaj në këtë shkresë. Kjo bie në kundërshtim me parimet dhe procedurat e përcaktuara në Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale dhe Ligjin për Prokurorin e Shtetit. Neni 3, paragrafi 3 i Ligjit për Prokurorin e Shtetit përcakton se “është e kundërligjshme dhe në kundërshtim me Kushtetutën për cilindo person fizik apo juridik që të ndërhyjë, pengojë, ndikojë apo të përpiqet të ndërhyjë, pengojë apo ndikojë te Prokurori i Shtetit gjatë kryerjes së funksioneve prokuroriale lidhur me cilindo hetim, procedurë apo lëndë individuale”.

Për më tepër Kryeministri Haradinaj, në përgjigjen drejtuar prokurorit Blakaj, në pikën tre kishte shkruar se hetimet në këtë rast do të zgjasin 30 ditë dhe se në fund të hetimeve prokurori obligohet t’ia dorëzonte Kryeministrit raportin e hetimeve dhe konstatimet e tij. Një qasje dhe kërkesë e tillë e Kryeministrit Haradinaj bie në kundërshtim të plotë në radhë të parë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e cila në nenin 4 të saj përcakton se Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre. Sipas Kushtetutës, Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ. Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit, Presidenti i Republikës së Kosovës është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës. Përderisa, Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar, kurse pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat.

Në rastin konkret, Kryeministri Haradinaj duke vepruar në kundërshtim me vlerat dhe parimet mbi të cilat funksionon ndarja e pushteteve në Republikën e Kosovës, kishte kërkuar nga prokurori Blakaj që t’i dorëzonte Kryeministrin raportin e hetimeve dhe konstatimet e tij lidhur me një rast që ishte duke u hetuar nga prokurori Blakaj.

Përgjigja e Kryeministrit Haradinaj në shkresën e prokurorit Blakaj, kufizonte edhe afatin e hetimeve në një procedurë penale. Përderisa, sipas Kodit të Procedurës Penale në parim hetimet zgjatin deri në 24 muaj, Kryeministri në shkresën e tij kishte dhënë afat prokurorit Blakaj 30 ditë për të hetuar këtë rast në ambientet e Qeverisë së Kosovës. Për më tepër, sipas Kodit të Procedurës Penale hetimet e kryera nga prokurori finalizohen me Aktakuzë dhe dërgohen në Gjykatë apo përfundojnë me aktvendim për pushimin e hetimeve.

Ndërhyrjet e Kryeministrit Haradinaj lidhur me këtë rast kanë vazhduar edhe në ditët në vijim, pas dorëheqjes së prokurorit Blakaj. Më 23 gusht 2018, Kryeministri Haradinaj përmes një postimi në facebook, kishte informuar publikun se iu kishte drejtuar ambasadorëve të akredituar dhe zyrtarëve të Zyrave Ndërlidhëse në Kosovë, duke shpjeguar me një letër përkrahjen e tij të pakusht ndaj të gjitha kërkesave të parashtruara nga prokurori i dorëhequr, Elez Blakaj, për tërë hetimin në Zyrën për Çështje të kategorive të dala nga Lufta e UÇK-së lidhur me çështjen e Listës së Veteranëve.

Edhe më shqetësuese lidhur me këtë adresim të Kryeministrit Haradinaj ishte fakti se i njëjti, korrespondencës me ambasadorët e huaj në Kosovë ia kishte bashkangjitur edhe komunikimin zyrtar mes tij dhe prokurorit Blakaj, respektivisht kishte dorëzuar tek shtetet e huaja prova apo dëshmi të një rasti që ende është në procedurë penale. Një qasje e tillë dëshmon ndërhyrjen e Kryeministrit Haradinaj në një procedurë penale duke përfshirë edhe shtetet e huaja në Kosovë, që në vete përfshinë edhe shkeljen e një varg ligjesh në Kosovë.

III. Dorëheqja e prokurorit Blakaj dëshmi e ndërhyrjeve politike në drejtësi

Prokurori Elez Blakaj më 13 gusht 2018 kishte ofruar letrën e dorëheqjes tek Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Kryeprokurori i PSRK-së, Reshat Millaku. Në letrën e tij Blakaj kishte njoftuar se para një muaji, përkatësisht më 11 korrik 2018, kishte ngritur aktakuzën në rastin e veteranëve të UÇK-së, të cilën ia kishte dorëzuar Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Reshat Millaku.

“Dëshiroj t’i falënderoj të gjithë kolegët me të cilët kemi bashkëpunuar gjatë tërë këtyre viteve, duke vlerësuar lartë ndihmën e bashkëpunëtorëve dhe zyrtarëve ligjorë. Se sa është i rëndësishëm bashkëpunimi, në veçanti vlen të ceket bashkëpunimi dhe ndihma e palodhshme e disa prej kolegëve në 10 muajt e fundit, në njërin nga rastet më voluminoze dhe komplekse, i quajtur si ‘Rasti i Veteranëve’, për të cilin rast nga 11 Korriku 2018, aktakuzën ia kam përcjell Kryeprokurorit Millaku”, shkruan Blakaj, në letrën e tij, duke theksuar se kishte qenë nder që të punonte në sistemin prokurorial, pavarësisht sfidave të shumta që kishte pasur në punën e tij.¹

Pas publikimit të letërdorëheqjes së Blakajt, në publik ishin shfaqur krerët e sistemit prokurorial dhe Prokurorisë Speciale, duke vlerësuar lartë punën e Blakajt si prokuror profesional dhe i

¹ “Prokurori i dorëhequr Elez Blakaj në korrik e ka ngritur aktakuzën e profilit të lartë për veteranët, të cilës i prin Agim Çeku dhe përfundon me Xhavit Jasharin, aktakuza “fjenë” në Prokurori Speciale”, Musliu B., 15 gusht 2018, www.betimiperdrejtesi.com Shih vegzën: <https://betimiperdrejtesi.com/prokurori-i-dorehequr-elez-blakaj-ne-korrik-e-ka-ngritur-aktakuzen-e-profilite-te-larte-per-veteranet-te-ciles-i-prin-agim-ceku-dhe-perfundon-me-xhavit-jasharin-aktakuza-flene-ne-pr/>

guximshëm, duke mohuar se ai ka qenë i kërcënuar në çfarëdo forme dhe se atij i kishin ofruar mbrojtje dhe ndihmë të vazhdueshme sistemi prokurorial, por që sipas tyre, Blakaj kishte vendosur për arsye personale të dorëhiqej. Sidoqoftë, të gjithë krerët e sistemit prokurorial kishin mohuar se prokurori Blakaj kishte ngritur aktakuzë në rastin e veteranëve mashtrues, duke pohuar se rasti ishte ende në fazën e hetimeve.

“Betimi për Drejtësi” për herë të parë kishte publikuar përmbajtjen e aktakuzës së veteranëve mashtrues dhe emrat e 11 anëtarëve të Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Veteranëve, të cilët ishin akuzuar si profil i lartë, duke filluar nga Kryetari Agim Çeku deri tek Xhavit Jashari.²

Pas këtij lajmi të publikuar, pasuan në publik reagimet e Kryetarit të Këshillit Prokurorial, Blerim Isufaj, Kryeprokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi dhe Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale, Reshat Millaku, duke demantuar lajmin për ngritje të aktakuzës dhe duke pretenduar se rasti ishte ende vetëm në fazën e hetimeve.

Pas tri ditësh, “Koha Ditore”³ më 17 gusht 2018 kishte publikuar aktakuzën e veteranëve mashtrues, në të cilën dëshmohej se prokurori special Elez Blakaj kishte ngritur një aktakuzë të nënshkruar me numër të rastit për veteranët mashtrues, ku përfshihej profili i lartë që ishin pjesë e Komisionit Qeveritar. Artikulli dëshmonte të gjitha detajet e aktakuzës, e cila ishte ngritur dhe nënshkruar nga prokurori Blakaj, por e cila ishte dorëzuar në zyrën e Kryeprokurorit Special Reshat Millaku dhe nuk ishte dërguar në Gjykatën Themelore të Prishtinës.

Kontestimi i vazhdueshëm i ngritjes së aktakuzës në publik nga krerët e sistemit prokurorial, solli reagimin e parë në publik të prokurorit të dorëhequr Elez Blakaj, i cili në rrjetin social facebook shkroi një letër me titull: *“Dorëheqja ime ka dy porosi: Protestë dhe mesazh”*.⁴ Në këtë letër, prokurori Blakaj ka shpjeguar arsyet e tij të dorëheqjes, të cilat kishin të bënin me ndikimet politike, presionet dhe kërcënimet e vazhdueshme në punën e tij si prokuror.

“Si protestë, në kuptim të shprehjes së pakënaqësisë dhe mospajtimit për një menaxhment skajshmerisht të politizuar, ku rastet e profilit të lartë shumë vështirë lejohen të kalojnë, e madje edhe kur arrin të kalojnë, i tërë procesi shantazhohet me qëllim që në fazat e me vonshme ato raste të dështojnë, sepse janë aty argat i politikës ditore”.

“Ndersa si mesazh, kjo vlen për kolegët, se me asnjë çmim nuk guxojmë t’i shesim parimet dhe dinjitetin tonë, para ngritjes në karrierë, apo për hater të shefave tonë, pagave që nuk i meritojmë,

² “Prokurori i dorëhequr Elez Blakaj në korrik e ka ngritur aktakuzën e profilit të lartë për veteranët, të cilës i prin Agim Çeku dhe përfundon me Xhavit Jasharin, aktakuza “fletë” në Prokurori Speciale”, Musliu B., 15 gusht 2018, www.betimiperdrejtesi.com Shih vegzën: <https://betimiperdrejtesi.com/prokurori-i-dorehequr-elez-blakaj-ne-korrik-e-ka-ngritur-aktakuzen-e-profilit-te-larte-per-veteranet-te-ciles-i-prin-agim-ceku-dhe-perfundon-me-xhavit-jasharin-aktakuza-flene-ne-pr/>

³ “Aktakuza: Zinxhiri komandues i mashtrimit në emër të UÇK-së”, Ramaj, S. 17 gusht 2018, Gazeta “Koha Ditore”. Shih vegzën: <https://www.koha.net/arberi/111595/aktakuza-zinxhiri-komandues-i-mashtrimit-ne-emer-te-uck-se/>

⁴ “Flet Elez Blakaj, thotë se kishte kërcënime nga veteranët, përmend presionin e Kryeprokurorit Aleksandër Lumezi për veteranët e UÇK-së dhe rastin “Pronto””, Betimi për Drejtësi, www.betimiperdrejtesi.com, 20 gusht 2018, Shih vegzën: <https://betimiperdrejtesi.com/flet-elez-blakaj-thote-se-kishte-kercenime-nga-veteranet-permend-presionin-e-kryeprokurori-aleksander-lumezi-per-veteranet-e-uck-se-dhe-rastin-pronto/>

kërcënimeve të ndryshme, favoreve tjera me motive të ulta, etj. sepse me qasjen tonë prej servili jemi duke kontribuar në shkatërrimin e shtetit tonë dhe shpresës për të ndërtuar një shtet ligjor, përpjekje dhe sakrificë e shumë gjeneratave, me përkrahje edhe të miqve tonë (mos na lasht Zoti pa ta!), të cilët jemi duke i humbur çdo ditë e më shumë!”

Në këtë reagim, prokurori i dorëhequr Elez Blakaj, thekson se gjatë ushtrimit të funksionit si prokuror por edhe familja e tij vazhdimisht kanë qenë të kërcënuar derisa ai kishte trajtuar raste të ndjeshme, sidomos raste të profilit të lartë të politikanëve. Në reagim, ai shpjegon se ka pranuar lloj lloj kërcënimesh, të cilat i ka tejkaluar dhe e ka kryer punën e tij me nder dhe profesionalizëm, duke thënë se ka ngritur aktakuzë për veteranët mashtrues, për të cilën nuk e kupton arsyen se pse ende nuk është dërguar në Gjykatë nga Kryeprokurori i Speciales, Reshat Millaku.

Të gjitha këto kërcënime dhe presione, Blakaj thotë se është dashur t'i lajmëroi, por ai ka pyetur publikisht se ku t'i lajmëroi, duke aluduar se nuk ka pasur adresë se ku të drejtohet për shkak të sistemit të kapur nga politika dhe grupet e interesit.

Tutje, prokurori i dorëhequr Blakaj ka njoftuar për dy raste, në të cilat Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, sipas tij, ka ndërhyrë në punën e tij si prokuror. Rasti i parë është rasti i **“Prontos”**, ndërsa rasti i dytë është **“Rasti i veteranëve mashtrues”**.

Ky reagim i Blakajt është pasuar me reagime dhe kërcënime të ashpra publike të Kryeministrit Ramush Haradinaj, i cili e ka fyer publikisht duke e quajtur “hajn të pulave dhe pishpirik”. Në përgjigje të reagimit të prokurorit Blakaj, Kryeprokurori Aleksandër Lumezi, i cili fillimisht e kishte lavdëruar Blakajn si prokuror profesional dhe të guximshëm, tanimë e cilëson si prokuror joprofesional dhe frikacak. Në një paraqitje publike në edicionin qendror të lajmeve në RTK, Aleksandër Lumezi, ka konfirmuar takimet me protagonistët e akuzuar në rastin “Pronto”, me të cilët kishte diskutuar për aktakuzën dhe pas takimit kishte ftuar në takim tre prokurorët e task forcës (*Drita Hajdari, Elez Blakaj dhe Lulëzim Sylejmani*), të cilët i kishte qortuar dhe kërcënuar me dërgim në Komision Disiplinor për shkak të ngritjes së aktakuzës ndaj disa individëve të caktuar në aferën “Pronto”, të cilët aktualisht edhe në Qeverinë Haradinaj janë në pozita të ministrave.

Reagimi i Blakajt dhe kundër reagimet e kërcënimit e politikës dhe sistemit prokurorial dëshmojnë gjetjet e vazhdueshme të monitorimit sistematik të IKD-së se ndikimi politik dhe i grupeve të interesit në sistemin e drejtësisë, përkatësisht në sistemin prokurorial janë evidente.

Ndikimi politik në sistemin e drejtësisë vazhdimisht është theksuar në raportet më relevante vendore dhe ndërkombëtare me theks të veçantë si Raporti i Progresit të Komisionit Evropian, Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit, Freedomhouse etj. Në këtë drejtim, një ndër indikatorët më të rëndësishëm që dëshmon këtë ndikim politik në sistemin e drejtësisë është besueshmëria e qytetarëve në punën e sistemin gjyqësor dhe prokurorial, e cila është ndër më të ulëtat pas përfundimit të luftës në Kosovë.

IV. Profili i prokurorit Elez Blakaj: Hero VS Frikacak

a) Elez Blakaj - prokuror hero

Profili i prokurorit special të dorëhequr Elez Blakaj për pak ditë u vlerësua në dy ekstreme, prej prokurorit hero, duke qenë profesional dhe i guximshëm deri tek frikacaku e hajni i pulave. Në një reagim publik në rrjetin social facebook, publicisti Veton Surroi, ka theksuar se nga *“shteti i kapur: ose shpallesh frikacak nëse strehohesh në Amerikë ose shpallesh burrë i mirë ditën tënde të varrimit, pas vetëvrasjes me 11 shpuarje thike”*⁵.

Vlerësimi i performancës së prokurorëve nga mekanizmat e brendshëm të sistemit prokurorial, nxjerrin prokurorin Elez Blakaj si një ndër prokurorët më të mirë në Republikën e Kosovës. Në fund të vitit 2017, sipas Komisionit për Vlerësimin e Performancës, Elez Blakaj ishte notuar me 3.7 nga nota 4 sa ishte maksimalja. Ndërsa, në vitin 2014, Blakaj ishte shpërblyer me çmim të veçantë për performancë të mirë në sistemin prokurorial. Ky çmim ishte ndarë derisa ishte Prokuror në Prokurorinë Themelore të Prishtinës *“për kontributin e jashtëzakonshëm për drejtësi në Kosovë përmes punës së tij profesionale në Prokurorinë Themelore në Prishtinë”*.⁶

Gjatë punës së tij si prokuror ai ka trajtuar raste të ndjeshme ndër më të veçantat janë rastet e trajtuara si prokuror në Prokurorinë Speciale si: rastet e terrorizmit, krimeve të luftës, rasti i “Prontos”, rasti i veteranëve mashtrues etj. Rasti i veteranëve është rasti më i madh pas përfundimit të luftës në Kosovës, i cili përfshinë profilin e lartë të Komandantëve si dhe afro 20 mijë veteranë mashtrues. Në këtë lëndë prokurori Blakaj, i cili ka ngritur aktakuzë ndaj profilit të lartë, të cilin e ka në kompetencë Prokuroria Speciale, pjesën tjetër të lëndës, ua ka deleguar për hetim dhe ndjekje shtatë Prokurorive Themelore të Republikës së Kosovës. Ndër të tjera, prokurori Blakaj në kuadër të këtij rasti, kishte iniciuar hetim penal edhe ndaj numri të madh të policëve, të cilët në mënyrë të kundërligjshme kishin përfituar në të njëjtën kohë edhe pagën e rregulltë në polici edhe si invalid veteranë.

Vlerësimet më pozitive për prokurorin e dorëhequr Elez Blakaj i kanë dhënë publikisht Kryesuesi i Këshillit Prokurorial, Blerim Isufaj, Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale, Reshat Millaku, Ambasadori Amerikan, Greg Delaëie etj. Krerët e sistemit prokurorial në ditët e para pas dorëheqjes lavdëruan profilin e Blakajt, duke e vlerësuar si prokuror shumë profesional dhe të guximshëm, duke theksuar se ai ka trajtuar raste të mëdha, në mesin e të cilave edhe rastin e veteranëve mashtrues. Ndërsa, Ambasadori Amerikan Delaëie pas paraqitjes së dorëheqjes së Blakajt, ishte shprehur i zhgënjyer duke u shprehur se *“është një ditë e trisht për sundimin e ligjit në Kosovë, kur një top prokuror, ndihet se duhet të japë dorëheqje për shkak të kërcënimeve dhe mungesës së mbështetjes, veçanërisht është trishtuese kur ai ka punuar në një rast të madh të mashtrimit me pensione.”*

⁵ “Surroi: Shteti i kapur të shpallë frikacak nëse strehohesh në SHBA ose burrë të mirë në ditën e varrimit”, www.koha.net, 20 gusht 2018. Shih vegzën: <https://www.koha.net/arberi/112360/surroi-shteti-i-kapur-te-shpalle-frikacak-nese-strehohesh-ne-shba-ose-burre-te-mire-ne-diten-e-varrimit/>

⁶ “Ndahet çmimi për drejtësi, “Heroi Sali Çekaj”. Gazeta “Koha Ditore”, 22 dhjetor 2014. Shih vegzën: <https://archive.koha.net/?id=27&l=38151>

Diplomati amerikan kishte thënë se ndjehet i zhgënjyer edhe për faktin se Blakaj ishte mbështetur nga qeveria amerikane për të studiuar në Eëake Forest ku kishte marr diplomën LLM dhe kishte hetuar raste të rëndësishme në Kosovë. Tutje Delaëie ka thënë se Kosova duhet të dëshmojë përkushtimin e saj ndaj sundimit të ligjit jo vetëm duke i mbështetur prokurorët, por edhe duke siguruar që të gjitha ata që dënohen të vuajnë dënimin.

Ambasadori Amerikan Delaëie kishte reaguuar edhe më 28 gusht 2018, përmes një postimi në Tëitter, ku kishte tërhequr vëmendjen e politikës dhe institucioneve të drejtësisë në Kosovë. Ai kishte deklaruar se është duke vëzhguar me kujdes hetimet për korrupsionin në dhënien e përfitimeve për veteranët. Delaëie kishte kërkuar që *“çështja të trajtohet pa kërcënime, frikësim dhe ndërhyrje politike. Qytetarët, e sidomos veteranët, duhet ta shohin sistemin teksa vendos drejtësi”*.

b) Elez Blakaj - prokuror frikacak

Të njëjtit krerë të sistemit prokurorial, të cilët e lavdëruan publikisht Elez Blakajn si prokuror shumë profesional dhe shumë të guximshëm, janë protagonistët e njëjtë që kanë tentuar ta baltosin profilin e Elez Blakajt, duke e quajtur tani si prokuror joprofesional dhe frikacak.

Pas reagimit publik në rrjetin social facebook, në të cilën prokurori Blakaj, kishte thënë se dorëheqja e tij kishte të bënte me protestë kundër sistemit prokurorial të ndikuar nga politika dhe mesazh për të gjithë bartësit e funksioneve prokuroriale që mos të nënshtrohen nga ndikimet politike, duke theksuar rastet konkrete të ndikimit politik dhe ndërhyrjet e drejtpërdrejta në punë nga Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi për raste të politikanëve, pikërisht Aleksandër Lumezi ndërroi qëndrimin, duke etiketuar publikisht Elez Blakajn tanimë si prokuror joprofesional dhe frikacak.

Në të njëjtën formë janë përpjekur ta etiketojnë përmes mungesës së përkrahjes edhe Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Shoqata e Prokurorëve të Kosovës, të cilat i dolën në mbrojtje Kryeprokurorit të Shtetit, ndërsa e sulmuan prokurorin Elez Blakaj.

Pas Kryeprokurorit Lumezi, protagonistin e cili më së shumti ka etiketuar dhe kërcënuar prokurorin Elez Blakaj është Kryeministri i Qeverisë, Ramush Haradinaj.

Më 20 gusht 2018, Kryeministri Haradinaj ishte mysafir në emisionin Interaktiv në KTV, në të cilin kishte sulmuar rëndë prokurorin Blakaj lidhur me ngritjen e aktakuzës në rastin e veteranëve mashtrues të UÇK-së. Haradinaj kishte thënë se prokurori Blakaj është “hajn i pulave dhe pishpirik”. Kryeministri Haradinaj më tutje kishte deklaruar se ky prokuror nuk ka të drejtë të flasë për veteranët, “kur vetë ka qenë në Bllacë apo Stankovec”. Ai ka thënë se nuk duhet askush të flasë për numrin e madh të veteranëve nga rajoni i Dukagjinit sepse, sipas tij, në të vërtetë ka pasur shumë luftëtarë nga atje.

“S’e di ku ka qenë prokurori gjatë luftës, në Bllacë apo ku? Sa i përket asaj që ka ndodhë në Dukagjin për luftë, i qëndroj prapa. Ata që i kam nënshkruar janë veteranë. Kanë qenë të mobilizuar i madh e i vogël. Çdo vendbanim ka qenë i furnizuar me armë. Lëvizje, qarkullim, ikje, kthim nga vendi i luftës ka në çdo kohë dhe në çdo luftë. Nuk është mirë të ofendohet pjesëmarrja në luftë e njerëzve të Dukagjinit sepse ka qenë numër i madh. Numri ishte i madh që ishin direkt

në luftë apo marrja pjesë në luftë në një kohë të caktuar. Qëndrimi im është i qartë, nuk ia mohoj askujt kontributin për liri. Atë që ia njih ligji e meritojnë. Mos u ankoni pasi është bërë ligji. Nëse dikush nuk është veteran atëherë duhet të merret ligji me të. Nëse është dikush 27 vjeçar sot e veteran, është i paligjshëm e duhet ta gjejë prokuroria, pse ka hy dhe kush e ka shti. Por në Dukagjin të thuhet se kanë hyrë shumë e s'kanë qenë në luftë, është marre për ata që flasin. Njerëzve prej Bllacës e Stankovecit nuk iu takon të flasin kush ka qenë në luftë në Dukagjin. Qysh po e di ai kush ka qenë në luftë? Unë tregoj se nuk e kam lëshuar kurrë luftën. Në Dukagjin i madh e i vogël, në qindra vendbanime, kanë qenë në luftë, nga njëqind njerëz të armatosur. E kanë fituar të drejtën me ligj. Është dashur të mendohej me kohë se a do t'i dalim zot të drejtës së tyre, por jo të çohet një pishpirik të ofendojë kontributin e tyre”, ka thënë Haradinaj.⁷

Edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli ishte përfshirë në debatin lidhur me dorëheqjen e prokurorit Elez Blakaj. Veseli përmes një postimi në facebook më 20 gusht 2018, kishte pranuar se ka fryrje të listave të veteranëve të UÇK-së, dhe për këtë nuk ka asnjë dilemë. “Një shqetësim i tillë më është shprehur nga shumë bashkëluftëtarë, gjë që më ka bërë edhe mua të kërkoj deri në fund hetimin e këtij procesi. Kam kërkuar qysh në fillim që për këtë drejtësi ta thotë fjalën e saj. Çdo pretendim për mashtrime në listat e veteranëve duhet të hetohet në mënyrë të plotë dhe të paanshme. Me vjen keq për luftëtarët e UÇK-së, që dikush po tenton të njollosë kontributin dhe sakrificat tyre. Por, edhe këtë betejë, të mbrojtjes së vlerave të luftës sonë, bashkëluftëtarë, do ta fitojmë, duke vendosur para drejtësisë, me emra dhe mbiemra, të gjithë ata që kanë hyrë në këto lista pa qenë luftëtarë të lirisë”, ka thënë Veseli.

“Në këtë betejë duhen njerëz të përkushtuar dhe të guximshëm në çdo institucion. Elez Blakaj, një prokuror që shteti i Kosovës ia kishte dhënë besimin, nuk pati guxim që këtë gjë ta çojë deri në fund, për çka e ka pasur mbështetjen time të plotë - si njeri, si luftëtar dhe si lider institucional e politik. Ai kishte menduar të bëhej prokuror hero pa e luftuar krimin, ashtu sikurse këta mashtrues që duan të bëhen veteranë pa pjesëmarrje në luftën çlirimtare”, ka theksuar Veseli.

“Me deklaratat nga SHBA-ja nuk luftohet krimi, për aq sa lufta nuk është fituar me deklaratat pa marrë pjesë drejtpërdrejt. Sido që të jetë, ky është morali të cilin e zgjedh vetë individi, më të cilin i edukon edhe fëmijët e vet. Ky proces do të shkojë deri në fund, për aq sa do të shkojë në fund edhe çdo pretendim që ka bërë ky prokuror. Listat do të hetohen. E vërteta do të dalë. Shteti i Kosovës i kishte besuar z.Blakaj dhe profesionalizmit të tij. Me ikjen e tij, ai tregon se nuk e do shtetin e Kosovës. Prokurorët që e duan shtetin e Kosovës, që jetojnë me shpirt në këtë vend, do ta përfundojnë këtë proces. Ikja e Elez Blakajt nga detyra, nuk duhet të jetë aspak dekurajim për njerëzit e këtij vendi, sidomos për profesionistët e drejtësisë. Siguroj qytetarët e Kosovës se mashtruesit e çdo lloji, as nuk do të mund ta njollosin emrin e lavdishëm të Ushtrisë Çlirimtare në Kosovës dhe as nuk do të mund ta dëmtojnë të ardhmen e Kosovës.”

⁷ Intervista e Kryeministrit Haradinaj në emisionin Interaktiv në Kohavision me 20 gusht 2018, në: <https://www.koha.net/arberi/112362/kryeministri-fyen-blakajn-thote-se-genjen-per-kercenime-nga-veteranet/>

V. Shqetësimet për kërcënimet dhe etiketimet publike të politikanëve kundër prokurorit Blakaj

Reagimet publike kundër prokurorit të dorëhequr Elez Blakaj nga vetë krerët e sistemit prokurorial por edhe nga politika, sidomos Kryeministri Ramush Haradinaj, kanë nxitur reagime të shumta tek ekspertët dhe aktivistët e shoqërisë civile, të cilët konsiderojnë se këto janë kërcënime të drejtpërdrejta në punën e prokurorëve të pavarur.

Përmes një komunikate për media, Fondi për të Drejtën Humanitare (FDH) thekson se, “pa marrë parasysh vendimin e Blakajt që të tërhiqet nga funksioni i tij për shkak të kërcënimeve të cilat i janë bërë pas hetimit të lëndëve të veteranëve të rrejshëm të luftës, ta vlerësosh një prokuror si “hajn pulash” dhe “pishpirik”, përbënë, që nga pavarësia e këndeje, fyerjen më të rëndë të cilën e ka bërë një prej funksionarëve më të lartë shtetëror të Kosovës në llogari të pjesëtarit të sistemit prokurorial”.

Aq më shumë, duke vlerësuar se, “njerëzit të cilët nuk kanë qenë në Bllacë ose Stankovec gjatë luftës në Kosovë nuk kanë të drejtë të numërojnë veteranët në rajonin e Dukagjinit”, ai ka ushtruar ndikim të drejtpërdrejt politik mbi prokurorinë.

“Kjo përbënë një precedent të rrezikshëm, i cili, nëse nuk reagohej ndaj tij dhe nëse deklarata nuk tërhiqet, e hap derën për përzjerje të mëtejme të drejtpërdrejtë dhe për trysni në sistemin prokurorial, i cili edhe sipas Kushtetutës dhe ligjit në mënyrë të plotë është i pavarur prej politikës”, thuhet në komunikatë.

FDH Kosovë vlerëson se kryeministri i Kosovës me deklaratën e tij në llogari të ish-prokurorit Blakaj i ka bërë një shërbim të keq përpjekjeve që në Kosovë të ndërtohet sistemi efikas dhe i pavarur i shtetit ligjor. “Aty ku funksionarët politik i japin vetes të drejtë për të nënçmuar dhe fyer funksionarët e gjyqësorit të shtetit, nuk ka sundim të ligjit, por është në fuqi pushteti i politikanëve të pushtetshëm”, thuhet në komunikatë të FDH.

FDH Kosovë kërkon nga kryeministri Haradinaj që ta tërheq deklaratën e tij dhe që publikisht t'i kërkoj falje zotëri Blakajt, por edhe gjithë sistemit prokurorial. Në të kundërtën, kërkohet nga deputetët e Kuvendit të nisin propozimin për votim të mosbesimit.

VI. Rasti Blakaj, dëshmi për iniciativën e drejtë të IKD-së për nevojën për veting në polici, prokurori dhe gjykata

a) Siguria juridike dhe fizike e prokurorëve dhe gjykatësve

Siguria e gjykatësve dhe prokurorëve luan rol vendimtar në administrimin e drejtësisë në një shoqëri demokratike ku sundon rendi dhe ligji, duke u bazuar në vlera dhe praktikë më të mira ndërkombëtare. Ofrimi i sigurisë individuale për këto kategori është parakusht për të siguruar në praktikë pavarësinë e organeve të drejtësisë në ushtrimin e funksioneve të tyre në mënyrë të drejtë, të paanshme, të pavarur dhe të bazuar në ligj. Praktikë dhe standardet ndërkombëtare i kushtojnë rëndësi të veçantë pavarësisë së gjyqësorit gjatë ushtrimit të funksioneve në praktikë. Për këtë arsye janë vendosur praktika dhe standarde të larta që ndërlidhen me pavarësinë e gjyqësorit. Kjo pavarësi duhet të garantohet nga shteti përmes Kushtetutës dhe ligjeve, sikurse obligohen institucionet qeveritare dhe shtetërore të respektojnë dhe të mbështesin pavarësinë e gjyqësorit.

Në rastin e prokurorit Elez Blakaj në mënyrë të koordinuar dhe të organizuar ka pasur një varg deklaratash nga krerët më të lartë shtetërorë, të cilët ndërhyjnë dhe kërcënojnë publikisht prokurorin Blakaj lidhur me trajtimin e rastit të veteranëve të luftës, duke cenuar rëndësi të sigurinë individuale të prokurorit Blakaj dhe familjes së tij, duke shkelur pavarësinë e sistemit prokurorial dhe gjyqësor.

Deklaratat e Kryeministrit Haradinaj, se prokurori Blakaj është “hajn i pulave dhe pishpirik” dhe se ky prokuror nuk ka të drejtë të flasë për veteranët, “kur vetë ka qenë në Bllacë apo Stankovec” gjatë luftës së Kosovës, jo vetëm që përbëjnë kërcënim për sigurinë individuale të prokurorit Blakaj dhe familjes së tij, por cenojnë rëndësi edhe pavarësinë e gjithë sistemit të drejtësisë në Kosovë. Gjykimi dhe poshtërimi publik që Kryeministrit Haradinaj i bën një prokurori, duhet vlerësuar edhe si mesazh për të gjithë prokurorët apo gjykatësit potencial që mund të trajtojnë rastin e veteranëve të luftës apo raste të ngjajshme ku preken profilet e komandantëve, politikanëve apo njerëzve të fuqishëm.

Qasje të përafërt me Kryeministrin Haradinaj, kishte edhe Kryeparlamentari Veseli, i cili kishte deklaruar se në këtë betejë duhen njerëz të përkushtuar dhe të guximshëm në çdo institucion. “Elez Blakaj, një prokuror që shteti i Kosovës ia kishte dhënë besimin, nuk pati guxim që këtë gjë ta çojë deri në fund, për çka e ka pasur mbështetjen time të plotë - si njeri, si luftëtar dhe si lider institucional e politik. Ai kishte menduar të bëhej prokuror hero pa e luftuar krimin, ashtu sikurse këta mashtrues që duan të bëhen veteranë pa pjesëmarrje në luftën çlirimtare.” Edhe Kryeparlamentari Veseli, përmes deklaratave të tij publike gjykon dhe përçmon personalitetin e prokurorit Blakaj, duke bërë përpjekje që në publik t’ia humb besimin e publikut.

Kryeprokurori i Shtetit Aleksandër Lumezi më 15 gusht 2018, pas dorëheqjes, kishte deklaruar se prokurori Blakaj nuk ishte tërhequr për shkak të kanosjes sepse kishte qenë prokuror i vendosur, i pa korrumpuar dhe i guximshëm, duke hetuar rastin e veteranëve mashtrues dhe duke përgatitur një draft aktakuzë, të cilën, sipas tij, e kishte shqyrtuar së bashku me kryeprokurorin e Prokurorisë Speciale, Reshat Millaku.

Ndërsa më 20 gusht 2018, Kryeprokurori Lumezi ka ndërruar në tërësi qasjen ndaj Blakajt, duke e quajtur frikacak dhe jo profesionist, duke dërguar mesazh në këtë mënyrë tek të gjithë prokurorët e tjerë, për pasojat që mund të kenë, në rast se vendosin të ndjekin rrugën e sinjalizuesit sikurse Blakaj për të raportuar në lidhje me ndikimet politike të Kryeprokurorit Lumezi në raste individuale.

Në të njëjtën intervistë, Kryeprokurori Lumezi ka pranuar ndërhyrjet e tij në punën e prokurorit Blakaj, duke theksuar se “është e vërtetë që unë e kam ftuar në zyrë Blakajn për me më tregu se përse e ka ftuar Kryetarin e Kuvendit të Kosovës Kadri Veselin për intervistim rreth rastit të veteranëve të luftës”. Për intervistimin e Veselit, Lumezi kishte deklaruar se “është absurde të intervistohet një deputet i Kuvendit, për diçka që flet në foltore”. Sipas Kryeprokurorit Lumezi, “Prokurori Blakaj duke thirrur në intervistim Kadri Veselin, ka dashur të shesë trimëri, lidhur me atë se unë po e thërras kryetarin e Parlamentit.”

Kjo qasje e Kryeprokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi, dëshmon për frikën e tij nga profili politikanëve, të cilëve ju shërben dhe të cilët praktikisht e jo formalisht e kanë sjellur në pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit. Afërsia dhe bashkëpunimi i Kryeprokurorit dëshmohej në aferën e përgjimeve “Pronto”, në të cilën vërtetohet se edhe pse kishte qenë duke ushtruar funksionin e prokurorit në ish-Prokurorinë e Qarkut në Prishtinë, kishte zhvilluar takime aso kohe pikërisht me protagonistët e aferës së përgjimeve “Pronto” që të kandidonte për Kryetar të Komandës së Prishtinës nga Partia Demokratike e Kosovës.

b) Qytetarët nuk kanë besim në sistemin e drejtësisë

Retorika në luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar asnjëherë nuk ka munguar nga të gjithë drejtuesit e institucioneve dhe agjencioneve të pavarura në Republikën e Kosovës. Megjithatë, korrupsioni është endemik dhe Kosova vuan nga mungesa e vullnetit për të luftuar korrupsionin. Vullneti i vetëm për ta luftuar korrupsionin me sukses, kanë mbetur politikat në letër dhe deklaratat boshe të krerëve të shtetit të drejtësisë. Monitorimi sistematik i IKD-së dëshmon se asnjëherë nuk kanë munguar as veprimet procedurale për të ofruar spektakël para qytetarëve dhe faktorit ndërkombëtarë për të krijuar përshtypjen e luftës kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar. Madje janë ngritur hetime e aktakuza edhe ndaj disa individëve të profilit të lartë, të cilat rrugës kryesisht kanë dështuar për shkak të joprofesionalizmit dhe urdhërave politik për trajtimin e atyre rasteve. Korrupsioni që ndiqet kryesisht i takon profilit të ulët, eventualisht të mesëm, të cilat në mbi 60% të aktakuzave dështojnë në gjykata.

Gjatë tri viteve të fundit janë ngritur edhe aktakuza të profilit të lartë, të cilat në mbi 90% të rasteve kanë dështuar të provohen. Shumica e tyre kanë dështuar qysh në fazën fillestare. Kjo dëshmon se shumica e këtyre rasteve hetimore apo aktakuzave të ngritura janë iniciuar qëllimisht ose për persekutim ose që ndaj këtyre zyrtarëve të ndërtohet amnisti e përhershme. Politizimi i skajshëm i institucioneve të pavarura si Policia, sistemi prokurorial dhe ai gjyqësor, po shërben si mjet i përsosur i kultivimit të kulturës së pandëshkueshmërisë së funksionarëve të lartë shtetërorë, bartësve brenda sistemit prokurorial dhe gjyqësor dhe të njëjtën kohë po shërben për promovimin e këtyre shkelësve të ligjit. Rekrutimi, avancimi dhe përzgjedhja e bartësve të këtyre institucioneve të rëndësishme assesi nuk mund të bëhet pa ndërhyrjen praktike të dorës së politikës, grupeve të interesit brenda dhe jashtë sistemit, e cila përkujdeset që pozitat kyçe të udhëhiqen nga njerëz me integritet të kontestuar dhe tërësisht të dëgjueshëm.

Ndikimi i skajshëm politik dhe mungesa e rezultateve konkrete e kanë cenuar rëndë integritetin e sistemit të drejtësisë, i cili ka ndikuar në humbjen e besimit të publikut dhe qytetarëve, për sundim të ligjit, respektivisht për sistemin e drejtësisë në Kosovë, me të cilin janë më së paku të kënaqur.

Sipas raportit të USAID dhe UNDP të publikuar në qershor 2018 - "Pulsi Publik XIV", rezulton se "nivelet e kënaqshmërisë me punën e gjyqësorit (gjykatat dhe prokuroria), është ulur me rreth 6 dhe 3 pikë përqindje që nga tetori 2017, respektivisht. Duhet të theksohet se nivelet e kënaqshmërisë me Prokurorinë dhe institucionet qendrore janë më të ulëta kur krahasohen me të gjitha institucionet e tjera. Kjo sugjeron se humbja e besimit në sundimin e ligjit dhe qeverisjen ka ndikuar në nivelet e përgjithshme të kënaqshmërisë me të gjitha institucionet e tjera." Sipas këtij raporti, kënaqshmëria e qytetarëve me prokuroritë në prill 2018 ka rënë në 29.9%, e cila njëherit paraqet besueshmërinë më të ulët nga të gjitha institucionet publike në Kosovë.

c) Protesta qytetare për shkarkimin e Kryeprokurorit Lumezi dhe për vetingun në gjyqësor

Si rezultat i kërcënimeve publike ndaj prokurorit të dorëhequr Elez Blakaj dhe ndërhyrjeve të politikës në gjyqësor, një grup i qytetarëve të Kosovës dhe aktivistë të shoqërisë civile kishin organizuar protestë me 22 gusht të vitit 2018 në Prishtinë me moton "Shkarkim Kryeprokurorit, Veting Gjyqësorit". Sipas organizatorëve të kësaj proteste arsyeja e protestës ndërli dhej me faktin se tash është e qartë se prokuroria është në shërbim të politikës. Edhe po të ketë prokuror/e si Elez Blakaj që ka vullnet për ta luftuar korrupsionin, do të pengohet nga Kryeprokurori Aleksandër Lumezi dhe Kryeministri Ramush Haradinaj. Qytetari i Republikës në rrethana të tilla duhet të jetë në krye të përgjegjësive dhe detyrave të veta qytetare. Tash, detyrë është kërkesa për shkarkimin e Kryeprokurorit Lumezi dhe fillimin e procesit të vetingut për gjyqësorin e Kosovës. Në protestën e organizuar më 22 gusht 2018 kishin marr me mijëra qytetarë të Kosovës.

Lidhur me gjendjen në sistemin e drejtësisë në Kosovë, kërcënimet ndaj prokurorit Blakaj dhe ndërhyrjet e politikës në sistem të drejtësisë kishte reagu edhe Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë. Në deklaratën e kësaj zyre të lëshuar më 22 gusht 2018, shprehej qëndrimi i Bashkimit Evropian se "pavarësia dhe autonomia e gjyqësorit, përfshirë prokurorinë, është e një rëndësie vendimtare në këtë kontekst dhe duhet të sigurohet". Bashkimi Europian ka ftuar të gjithë të përmbahen nga ndonjë sulm i mundshëm kundër institucioneve të sundimit të ligjit, duke përfshirë këtu dhe çdo koment personal apo shpifës ndaj prokurorëve apo gjyqtarëve individualë. "Deklaratat e disa politikanëve dhe prokurorëve të Kosovës në këtë drejtim minojnë parimet kryesore të sundimit të ligjit. Për më tepër, ata gjithashtu dërgojnë sinjale dekurajuese për të gjithë zyrtarët gjyqësorë që merren me raste të ndjeshme dhe të rëndësishme".

Organizatorët e iniciativës #Protestoj, kanë mbajtur sërish protest qytetare më 29 gusht 2018, në të cilën poashtu kanë marr pjesë mijëra qytetarë, me kërkesat për drejtësi të pavarur, për shkarkim të Kryeprokurorit Aleksandër Lumezi, për veting gjyqësorit si dhe me kërkesën që listat e veteranëve të UÇK-së të pastrohen dhe dinjiteti i veteranëve të vërtetë të kthehet.

Protestës i kanë dalur në mbështetje edhe 14 organizata të shoqërisë civile, të cilat kanë përkrahur protestën e organizuar nga grupi i qytetarëve për shkarkimin e Kryeprokurorit të shtetit,

Aleksandër Lumezi, duke thënë se letra shpjeguese e ish-prokurorit special Elez Blakajt, sinjalizon integritetin e dobët të sistemit të drejtësisë, në veçanti prokurorisë së shtetit, përballë ndërhyrjeve politike, shantazheve dhe kërcënimeve.

“Pas dorëheqjes së ish prokurorit special z. Elez Blakaj, ne si organizata të shoqërisë civile përkrahim plotësisht protestën e organizuar nga grupi i qytetarëve për shkarkimin e kryeprokurorit të shtetit z. Aleksandër Lumezi. Letra shpjeguese e z. Blakaj sinjalizon integritetin e dobët të sistemit të drejtësisë, në veçanti prokurorisë së shtetit përballë ndërhyrjeve politike, shantazheve dhe kërcënimeve, që vijnë edhe nga vetë kryeprokurori i shtetit”, thuhet në njoftim. Ndër të tjera, organizatat e shoqërisë civile kanë thënë se ndërhyrjet e Kryeprokurorit Lumezi për të shmangur përballjen e figurave të larta të politikës me procesin e drejtësisë janë alarmante për drejtësinë në Kosovë.

“Dorëheqja e kryeprokurorit Lumezi, do të rriste besimin qytetarë në drejtësinë e pavarur, prandaj ne përkrahim protestën qytetare, dhe kërkojmë që përveç shkarkimit të tij të fillojë edhe procesi i vetingut në sistemin e drejtësisë sikurse në të gjitha vendet e rajonit”, theksohet në njoftim. Në njoftim thuhet se këto organizata besojnë fuqishëm se vetëm një sistem i drejtësisë i pavarur, me integritet dhe imun ndaj interferimeve të politikës do të mund të garantojë sundimin e ligjit, që është parakusht për funksionimin e shtetit demokratik.

d) Vetingu si zgjidhje e paalternativë

Edhe përkundër se PSRK në Kosovë vepron prej vitit 2008, kjo prokurori nuk ka dëshmuar se është e gatshme dhe ka vullnet për të ushtruar kompetencat dhe përgjegjësitë e saj në bazë të Kushtetutës dhe Ligjit. Që nga viti 2008 deri në vitin 2014, prokurorët ndërkombëtar të EULEX-it në PSRK kishin mandat ekskluziv në trajtimin e rasteve më të ndërlikuara dhe komplekse në Kosovë. Edhe përkundër kësaj, Kosova edhe në vitin 2017, është sinonim i një shteti ku mungon sundimi i ligjit, dhe ku kultura e pandëshkueshmërisë në rastet e korrupsionit të nivelit të lartë edhe standard jetese. Të korruptuarit dhe shkelësit e ligjit vazhdimisht promovohen dhe janë shndërruar në “model të suksesit” për arritje në Kosovë. Nga viti 2014, kompetencat e rezervuara për EULEX-in në ndjekjen dhe gjykimin e rasteve më të rënda, ndërlikuara dhe komplekse në Kosovë janë transferuar tek prokurorët dhe gjykatësit vendor, përveç rasteve që kanë pasur në punë prokurorët 22 dhe gjykatësit ndërkombëtar të EULEX-it para vitit 2014.

Që nga transferimi i kompetencave tek vendorët në vitin 2014, në Kosovë janë raportuar dyshime për vepra penale të krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë. Në rastet kur janë të përfshirë, figura të larta politike, grupe të interesit, apo njerëz nga grupe të fuqishme të biznesit, Prokuroria nuk ka pasur vullnet dhe nuk ka gjetur guximin për të ushtruar kompetencat dhe përgjegjësitë kushtetuese dhe ligjore për të iniciuar procedura penale në këto raste.

Raportet e organizatave vendore dhe ndërkombëtare që monitorojnë sistemin e drejtësisë në Kosovë, në mënyrë të vazhdueshme kanë raportuar për politizim të skajshëm të sistemit gjyqësor dhe prokurorial në Kosovë. Raportet e Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën, Raportet e Departamentit të Shtetit Amerikan, konkluzionet e nëngrupeve të takimeve lidhur me MSA mes Komisionit Evropian dhe Kosovës konstatojnë mungesën e rezultateve në luftën kundër krimit të

organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë në Kosovë, politizimin e institucioneve të pavarura, përfshirë sistemin e drejtësisë, instalimin e kulturës së pandëshkueshmërisë, etj.

Publiku në Kosovë, media, OJQ-të, qytetarët, shërbyesit civil, administrata shtetërore në ato raste kur ballafaqohen me dukuritë e korrupsionit në Kosovë nuk kanë një adresë të besueshme për të raportuar të njëjtat. Instalimi i kulturës së pandëshkueshmërisë ka rritur mungesën e besimit që këto dukuri t'i raportojnë tek institucionet kompetente që këto raste t'i trajtojnë në mënyrë të pavarur, paanshme dhe profesionalisht.

IKD në vazhdimësi përmes raporteve të monitorimit sistematik të sistemit të drejtësisë ka shpërfaqur problemet me të cilat përballet sistemi i drejtësisë në Kosovë, me mungesë efikasiteti, llogaridhënie, transparence, korrupsion të brendshëm dhe mungesë besimit nga ana e publikut. Në këtë drejtim një proces i vetingut është i pakompromis dhe rruga të vetme e depolitizimit të sistemit të drejtësisë në Kosovë. Qytetarët dhe publiku nuk e kanë luksin që të durojnë shkeljen e të drejtave dhe lirive të tyre nga një sistem i cili në vend të ndarjes së drejtësisë është shndërruar në shkelësin më të madh të drejtave dhe lirive të qytetarit.

Rasti i fundit i dorëheqjes së prokurorit special Elez Blakaj ka dëshmuar përmes rasteve konkrete ndërhyrjet politike tek Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, i cili të njëjtat ndikime i ka vazhduar tek vartësit e tij. Gjithë kjo situatë ka dëshmuar përfundimisht kapjen e sistemit të drejtësisë, sidomos sistemit prokurorial nga politika në stilin e aferës së përgjimeve "Pronto", ku disa prej protagonistëve të kësaj afere janë në krye të sistemit prokurorial, duke filluar prej Kryeprokurorit Lumezi deri tek Bahri Hyseni dikur pjesë e PDK-së, ndërsa tani në rolin e anëtarit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

IKD vlerëson se në këtë situatë të krijuar, e cila shihet e pashpresë, është nevojë e domosdoshme që Kosova të filloj më veprime konkrete drejt procesit të vetingut në Polici, Prokurori dhe Gjykata. Përmes këtij procesi duhet të sigurohen qytetarët e Kosovës se vetingu do të bëhet në mënyrë të pavarur, të drejtë dhe të paanshme. Integriteti i tërë këtij procesi do të garantohej nëse ai do të realizohej nën udhëheqjen e shteteve mike që kanë mbështetur shtet ndërtimin e Kosovës ndër vite si SHBA, Britania e Madhe dhe Gjermania.